

VENDIM
Nr.1564, datë 26.11.2008

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.202, DATË 21.2.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA, QË
DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE, KOMUNA
THUMANË, TË QARKUT TË DURRËSIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.202, datë 21.2.2008 të Këshillit të Ministrave, të shtohet edhe lista e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 2 (dy), e që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Thumanë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULAR PËR NJË NDRYSHIM NË TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.202, datë 21.2.2008

(sipas inventarizimit të pronave të veçanta të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: MMPAU Komuna: Thumanë											
Nr. rendor	Nr.i pronës sipas VKM	Emërtesa e ekonomisë pyjore dhe kullosore EPK	Emërtesa e ngastrës, vendndodhja (sipas emërtesës popullore)	Numri i ngastrës	Destinacioni	Sipërfaqja e parcelës në ha	Sipërfaqja që do të hiqet	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësi administrative	Institucioni, enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1	292	Krastë Krujë (Ek.P)	Bokë Kuqe sheshet	11	pyll prodhues	25	12	1 punimi+dru zjarri	mmpau (dppk)	dshp	I mbeten komunës 13 ha
2	293	Krastë Krujë (Ek.P)	Faqe Grykë Dardhe	12	pyll prodhues	4.00	4	1 punimi+dru zjarri	mmpau (dppk)	dshp	

